




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. Br Prot 01-2576/14
Dep. Dep.	Prot No.
Nr. I faq. Broj stranica 03	Data Datum 11.07.2014
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	11.07.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Mujë FERATI Drejtor Zyrës së Prokurimit në Spitalin Sheikh Zayed Vushtrri
CC:	z. Rexhep KOVAÇI U.D. Drejtor i Spitalit Sheikh Zayed Vushtrri
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me Inventar Medicinal dhe Administrativ "



I nderuari z. FERATI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Furnizim me Inventar Medicinal dhe Administrativ " me numër prokurimi: 70700-14-033-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Furnizim me Inventar Medicinal dhe Administrativ" me numër prokurimi: 70700-14-033-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Spitali Sheikh Zayed në Vushtrri ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "Furnizim me Inventar Medicinal dhe Administrativ" me numër të prokurimit 70700-14-033-121 (ri-tenderim), i cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.27.06.2014 në Procedurën e Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) pranë Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa të dhëna të cilat bien ndesh me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga Autoriteti kontraktues ka konstatuar të faktet si në vijim:

Në njoftimin e publikuar për kontratë dhe fletën e të dhënave të tenderit të dosjes së tenderit tek rubrika III.2 Kushtet për pjesëmarrje pika 5 Autoriteti kontraktues ka kërkuar Referenca apo kontrata të llojit të njëjtë pa i kërkuar të njëjtat në 3 vitet e fundit, kërkesë për të cilën konsiderojmë se nuk është në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik. Sipas LPP-së një Autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kritereve të përzgjedhjes të kërkojë, kontrata dhe referenca për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorëve ekonomik. Në qoftë se Autoriteti kontraktues kërkon kontrata dhe referenca për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të Operatorëve ekonomik, atëherë detyrimisht këto kontrata dhe referenca duhet ti kërkojë në tri vitet e fundit në pajtim me LPP-në.

Tek rubrika III.2.3 e Kapacitetit ekonomik dhe financiar është kërkuar qarkullimi bankar për vitin 2013, kërkesë kjo për të cilën Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se bie ndesh me Udhëzimin administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Sipas Udhëzimit administrativ të lartcekur, një Autoritet kontraktues mundet të kërkojë dëshmi me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat për qarkullim duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues nuk mundet të kërkojë qarkullim financiar vetëm për vitin 2013 pa e kërkuar atë në 3 vitet e fundit.

Duke kërkuar qarkullim bankar vetëm për vitin 2013 si dhe duke kërkuar kontrata dhe referenca pa i kërkuar të njëjtat në 3 vitet e fundit, Autoriteti kontraktues e kufizon apo e zvogëlon konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik, prandaj veprimet e Autoritetit kontraktues në këtë mënyrë konsiderohen edhe shkelje e nenit 7 të LPP-së.



Tek pjesa e kritereve për dhënie të kontratës, Agjencia vëren se Autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kriterë i ka caktuar **1. Çmimin** të cilit i ka caktuar peshën prej 60%, si nën kriter 2 ka caktuar **Karakteristikat funksionale** (cilësia, kostoja e shpenzimeve) të cilin e ka peshuar me 25% dhe nën kriterin **3. Data e liferimit të mallit**, fillimi i periudhës së dërgesës dhe periudha e përfundimit të cilit i ka caktuar peshën prej 15%. Lidhur me nën kriterin 3 Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një nën kriter i tillë nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë si kriter për dhënie të kontratës nga Autoriteti kontraktues.

Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas ligjeve në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kriterë për dhënien e kontratës, andaj konsiderojmë se ky kriter i vendosur nuk është kriter i matshëm dhe do duhej të caktohej si kriter minimal për kualifikim.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 23 Kriteret e përzgjedhjes e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikata e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !